



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/319
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4/I73-2 Prot.
Nr. Dok. 202503481/2

Tiranë 3/11/2025

Lënda: Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisaratin e Policisë
Tepelenë

Drejtuar: Z. Altin MERIZAJ
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë

GJIROKASTËR

Z. Ilirjan DEMAJ
Shef i Komisarariatit të Policisë

TEPELENË

Për dijëni: Drejtues Madhor Ilir PRODA
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

TIRANË

Të nderuar,

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke vlerësuar angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona, në vijim po ju njohim mbi gjetjet e inspektimit që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në Komisaratin e Policisë Tepelenë më datë 18.09.2025.

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, seksion pranë Avokatit të Popullit, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "*Për Avokatin e Popullit*", i ndryshuar, kreu këtë inspektim në Komisaratin e Policisë Tepelenë.

Inspektimi u krye sipas Planit Vjetor të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Gloria Çarkaxhiu, znj. Nertila Qafzezi dhe znj. Lindita Dedegjoni me detyrë Nd/Komisionere pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit” si dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, për miratimin e procedurës standarde *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”*, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra në inspektimin pararendës. Inspektimi ishte i paparalajmëruar.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues të MKPT-së, ka detyrimin ligjor t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, të referuara në vijim:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetasit e privuar nga liria, grupi i inspektimit u takua me shefin e Komisarariatit z. Ilirjan Demaj i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim të takimit, z. Demaj informoi grupin e inspektimit mbi masat e marra për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit referuar inspektimit të mëparshëm, lidhur me përmirësimin e kushteve të ambienteve të shoqërimit të këtij Komisaritati.

Grupi i inspektimit, pasi mori informacionin e nevojshëm vijoi takimin me punonjësën e zyrës së informacionit të dhomave të shoqërimit, inspektoi mjediset ku mbahen dhe trajtohen personat e shoqëruar, verifikoi dhe administroi dokumentacionin që plotësohej prej punonjësve të policisë sipas procedurave standarde, si dhe vizitoi zyrat e specialistëve të policisë të këtij institucioni që kryejnë veprime procedurale me shtetasit e shoqëruar.

Në Komisariatin e Policisë Tepelenë, oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit e shoqëruar në zyrat e tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta intervistimi të monitoruara me kamera për këqyrjen e veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Nga monitorimi që u bë zyrave të oficerëve të policisë gjyqësore, nuk u gjetën sende prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Në këtë Komisariat kishte një dhomë magazinë për administrimin dhe ruajtjen e provave materiale, të administruara gjatë procedimeve penale nga specialistët e krimeve si dhe materialet e tjera të ndryshme.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, rezultoi se¹:

- Nuk ishte realizuar rekomandimi për marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për të mundësuar rikonstruksionin e përgjithshëm të godinës së Komisarariatit të Policisë Tepelenë me qëllim për ta kthyer atë në një institucion me standarde bashkëkohore dhe dinjitoze, si për personat e shoqëruar ashtu edhe për punonjësit e policisë.
- Nuk ishte realizuar rekomandimi për marrjen e masave të menjëhershme për krijimin e ambienteve të përshtatshme ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra dhe brenda dhomave të shoqërimit.
- Nuk ishte realizuar rekomandimi për marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin brenda ambienteve të shoqërimit ose ngjitur me to, tualete të ndara më vete për femra dhe meshkuj, të pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim.

Avokati i Popullit konstaton se ka një angazhim nga drejtuesit e Komisarariatit Tepelenë dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Gjrokastër (D.V.P.) të cilët me shkresën nr. 757/1 prot., datë 02.04.2025, i janë drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (D.P.P.SH.) me një Detyrë-Projektim “*Rikonstruksion/Ndërtim i objekteve të Komisarariatit të Policisë Tepelenë*” për adresimin e problematikave dhe zgjidhjen e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të vitit pararendës, të cilat lidhen ngushtësisht me përmirësimin e kushteve dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut sipas dhe sjellja e tyre në nivelet e kërkuara ligjore.

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre.

Në Komisariatin e Policisë Tepelenë ambienti i shoqërimit ishte i ndërtuar pjesërisht sipas kushteve dhe kriterëve të mbajtjes dhe qëndrimit të personave të shoqëruar, sikurse përcaktohen në procedurën standarde “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Në këtë Komisariat kishte 3 (tre) dhoma shoqërimi, të cilat ndodheshin në katin e parë të një ndërtese brenda territorit të këtij organi, në hyrjen e tij. Nga inspektimi, u evidentua se gjendja teknike e godinës së komisarariatit ishte e amortizuar dhe kishte

¹ Shkresa nr. K4/I80-2 prot., datë 31.10.2024, “*Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisariatin e Policisë Tepelenë*”.

nevojë për ndërhyrje për rikonstrukcionin tërësor të saj. Megjithatë, dhomat e shoqërimit ishin të lyera dhe të mirëmbajtura.

Në këtë Komisariat ishte vendosur sistemi i monitorimi me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit të ambientit të shoqërimit, megjithatë **mungonin** kamerat brenda dhomave të shoqërimit sipas përcaktimeve të procedurës standarde.²

Mbikëqyrja me kamera e të gjitha mjediseve të komisariatit, përveç atyre mjediseve ku cenohet privatësia, është vlerësuar nga ana e institucionit tonë, si një proces thelbësor për tre arsye:

Së pari, mbikëqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjshme që mund të kryhen, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Së dyti, mbikëqyrja me kamera dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambienteve të komisariatit, si dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm për masat disiplinore apo penale që duhet të merren ndaj individëve përgjegjës.

Së treti, dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe të paanshme në rekomandimet përkatëse që hartojnë institucionet monitoruese të pavarura.

Në korridorin e ambientit të shoqërimit ndodhej një tualet i cili përdorej nga personat e shoqëruar, ai ishte i pastër dhe i pajisur me lavaman dhe ujë të ngrohtë e të rrjedhshëm 24 orë, por ky ambient nuk kishte tualete të ndara më vete për gra dhe burra sipas sipas parashikimeve në procedurën standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022.

Gjatë kohës së kryerjes së inspektimit në dhomat e shoqërimit nuk kishte persona të shoqëruar.

Kapaciteti fizik për secilën dhomë shoqërimi ishte për qëndrimin ulur të 4 deri 5 personave dhe hapësira e tyre ishte afërsisht 3x4 m.

² Kreu VI pika 4 germa “g” e procedures standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, ku përcaktohet se: “Të gjitha ambientet e dhomave të shoqërimit monitorohen me sisteme të kamerave (përfshijë tualetin) si ambienti i brendshëm i dhomave të shoqërimit, korridori i tyre dhe pjesa e jashtme e dhomave të shoqërimit, të cilat lidhen dhe transmetojnë pamjet/imazhet në monitorë të vendosur në shërbimin e Sallës së Komandimit/shërbimit të informacionit të DVP/komisariatit/stacionit të policisë.”

Në ambientin jashtë dhomave të shoqërimit gjithashtu edhe brenda tyre ishin të afishuara postera edhe në gjuhë të huaj me të drejtat e personave të shoqëruar në mjediset e policisë së shtetit, gjithashtu ishin vendosur dhe brenda dhomave të shoqërimit për gra dhe të mitur në konflikt me ligjin.

Përgjatë inspektimit konstatuam se personave të shoqëruar nga policia **nuk ju jepej** informacioni për të drejtat e tyre në formë shkresore, që nga fillimi i privimit të lirisë, për të siguruar informim të qartë në lidhje me të drejtat ligjore/procedurale që ata kanë.

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës sugjeron dhënien e kartës të drejtave që në momentin e hyrjes në Komisariat. “Karta e të Drejtave” i shërben jo vetëm qytetarit, por edhe vetë Policisë së Shtetit, për të mirëmbajtur besimin e qytetarëve tek ajo, për ta forcuar bindjen se ajo është një instrument profesional shërbyes dhe jo dhunues i qytetarëve, si dhe për të evidentuar e veçuar abuzuesit me uniformën e policisë.

Gjithashtu, referuar raportit të Komitetit për Parandalimin e Torturës (KPT)³, nënkuptohet se karta me të drejtat që gëzojnë personat kur hyjnë në mjediset e policisë, duhet t’u jepet edhe personave që mbahen në dhomat e shoqërimit, pra që në momentet e para të privimit të lirisë. Kjo, pasi këtyre personave ju kufizohet liria deri në 5 orë (maksimumi) qëndrimi në dhomat e shoqërimit, ata merren në pyetje nga specialistët e policisë apo kanë të drejtë për njoftimin e familjarëve të tyre, e drejta për qasje me avokat mbrojtës, etj.

Dhomat e shoqërimit ishin të pajisura me tavolina dhe stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, por nga inspektimi konstatuam se ato ishin të dëmtuara dhe kishin nevojë të zëvendësoheshin me të reja.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisariatit të Policisë Tepelenë nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar, dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisariatit të Policisë Gjirokastrë.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisariatit të Policisë Tepelenë, “*Regjistri i evidentimit të dhënave për personat e shoqëruar*” ishte i tipit “*Model nr. 1*” konform me procedurat standarde miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit procedura standarde e punës “*Rregullat për*

³ <https://rm.coe.int/1680ae233b>, raport drejtuar Qeverisë Shqiptare mbi vizitën e KPT në Shqipëri të kryer në datat 4-15 maj 2023.

trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të parashikuara në ligjin nr.82 /2024 “Për Policinë e Shtetit”, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se: koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 5 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar me saktësi nga punonjësit e policisë të këtij institucioni. Punonjësit e policisë sqaruan se si orar shoqërimi fillestar vendosej momenti i arrestimit/ndalimit në vendin e privimit të lirisë, në çdo rast ky orar shërben në momentin e hyrjes së personave në Komisariatin e Policisë Tepelenë por edhe në procedurat që ndiqen lidhur me arrestimin e personave kur ekzistojnë kushtet që urdhërohet arrestimi i tyre.

Në këtë komisarjat kishte regjistër për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Ky regjistër ishte i plotësuar me korrektësi në të gjitha rubrikat e tij.

Në zyrën e informacionit të Komisarjatisë të Policisë Tepelenë administrohej një regjistër më vete për evidentimin e të dhënave të personave të mitur të shoqëruar, në bazë dhe të rekomandimit të Avokatit të Popullit për këtë qëllim⁴. Regjistri ishte i sekretuar.

Nga verifikimi i regjistrit të kërkesë/ankesave, nuk rezultoi të kishte raste apo pretendime të evidentuara për trajtim denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike e psikologjike, nga punonjësit e policisë të komisarjatisë.

Përgjatë periudhës janar-shtator 2025 ishin shoqëruar 36 persona, nga të cilët 32 burra, 3 gra dhe 1 i mitur.

Avokati i Popullit thekson se plotësimi i regjistrave në kohë dhe me korrektësi është një standard thelbësor me efekt parandalues për të garantuar të drejtat e njeriut.

Ambientet e intervistimit

Në Komisarjatin e Policisë Tepelenë oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e punës së tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta hetimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

⁴ Rekomandim nr.437 prot., datë 11.10.2019, “Për garantimin e të drejtave të të miturve të privuar nga liria në zbatim të legjislacionit të ri të administrimit të drejtësisë penale për të mitur”.

Përgjatë inspektimit u konstatua se specialistët dhe ndihmës specialistët e policisë vijonin të kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e punës së tyre.

Krijimi i zyrave të veçanta ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, është rekomandim i Avokatit të Popullit referuar standardeve ndërkombëtare, të cilat e konsiderojnë procesin e monitorimit filmik si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga vetë punonjësit e Policisë së Shtetit, ashtu dhe nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve. Ky standard ka gjetur rregullim edhe në procedurën standarde të miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022 *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, duke u shndërruar në rregull të detyruar për punonjësit e policisë.

Ndihma juridike dhe psikologjike

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat kryesisht.

Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë. Përgjatë inspektimit në Komisariatit të Policisë Tepelenë, u konstatua se kishte një listë të afishuar në ambientet e komisaritit ku mund të evidentoheshin avokatët kryesisht.

Punonjësit e policisë pasqyruan për grupin e inspektimit se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut.

Ndërsa psikologu sigurohej në bashkëpunim me shkollat e mesme të qytetit të Tepelenës ose nga DVP Gjirokastrë. Gjatë verifikimit të regjistrave të personave të shoqëruar u konstatua se procedura e ndjekur nga punonjësit e Komisaritit të Policisë Tepelenë ishte zhvilluar konform ligjit.

Grupi i inspektimit të Avokatit të Popullit këqyri disa praktika të njëpasnjëshme ku në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë në Komisaritit të Policisë Tepelenë, u konstatua se *“Procesverbalet e Shoqërimit”*, ishin të plotësuar në të tëra rubrikat e tij.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3, të nenit 63, të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në bazë të nenit 21/b, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

REKOMANDOJMË :

1. Marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për të mundësuar rikonstruksionin e përgjithshëm të godinës së Komisarariatit të Policisë Tepelenë me qëllim për ta kthyer atë në një institucion me standarde bashkëkohore dhe dinjitoze, si për personat e shoqëruar ashtu edhe për punonjësit e policisë.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për krijimin e ambienteve të përshtatshme ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra dhe brenda dhomave të shoqërimit.
3. Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin brenda ambienteve të shoqërimit ose ngjitur me to, e tualeteve të ndara më vete për femra dhe meshkuj, të pajisura me elementet e domosdoshme për këtë qëllim.
4. Marrjen e masave të nevojshme, për zëvendësimin e tavolinave dhe karrigeve/stolave si dhe vendosjen e kamerave brenda dhomave të shoqërimit.
5. Të merren masat për administrimin në zyrën e oficerit të informacionit të kartës së të drejtave në formë shkresore për të gjithë personat të cilët shoqërohen në ambientet e Komisarariatit Tepelenë.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

**KOMISIONERI
i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)
Ahmet PRENÇI
d.v**